



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 27.04.2018

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“QENDËR GRUMBULLIMI PËR RUAJTJEN, DISTRIBUIMIN DHE EKSPORTIN E
FRUTAVE, PERIMEVE DHE AGRUMEVE” ME VENDNDODHJE NË BASHKINË
LUSHNJE”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Doni Fruits” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Qëndër grumbullimi për ruajtjen, distribuimin dhe eksportin e frutave, perimeve dhe agrumeve” me vendndodhje në Bashkinë Lushnje”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Doni Fruits” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Lushnje.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

NIKO PELESHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

